8918

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 8918 Vendimit

V E N D I M

PER

REGJISTRIMIN E SUBJEKTIT JURIDIK

Me gjyqtarin Marjana Dedi me datë ___.4.1995, mbrëma me shqyrtim kërkesën e paraqitur nga kërkuesi SHAIK AHMET ISMAILI, me anën e të cilës kërkon regjistrimin e personit juridik të Shoqërisë Tregtare Private "ALL-STAR", dhe :

K O N S T A T O V A :

Se, kërkesa e tij është e mbështetur në nenin 5 të Ligjit Nr. 7514, datë[illegible].8.1991, si dhe të Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Mbi shoqëritë tregtare private", prandaj duhet t'i pranohet.

Aktiviteti që duhet të praniojë dhë ushtrojë Shoqëria do të jetë :

Me fushën e n d e r t i m i t, shfrytëzimit, përpunimit e tregtimin e materialeve të ndërtimit, duke pasur për bazë ato të ndërtimit të objektove të ndryshme, përdorimit të materialeve për instalime hidraulike e elektrike. Shitblerje me shumicë dhë pakicë, EKSPORT IMPORT të mallrave të ndryshme industriale, ushqimore, ushqim social, bar-bufe, restorant, konfekcione, tekstile, produkte bujqësore dhë blegtorale, fruta perime, pulë e elektro shtëpiake, hidro ambitare, elektrike, elektronike artikuj kimikë, plastikë, lëkurë, lëndë drusore, lëndë të para djegëse fabrikate, makineri e pajisje si dhë pjesë këmbimi për to. Transport mallrash të ndyshme e udhëtarësh si brenda edhë jashtë vendit. Operacione tregtare komisionarie e marketingu. Shërbime e operacione bankare, financiare, të kambiatit etj. Investime e pjesëmarrje me shoqëri të tjera shqipëtare ose të huaja në fushë të ndryshme si në industri, ndërtim, përpunim e shfrytëzim të materialeve të ndryshme ndërtimore, bujqësi, transport, industrinë ushqimore, turizëm, hotelëri etj. Punime me material ale të porositësit. Përdorim ndërtesash e depoash për magazina etj.

Si dhë çfar do lloj veprimtarie tjetër që do të shikohet e arësyeshme dhë me interes nga Shoqëria Tregtare Private "ALL-STAR" SHPK.

Aktiviteti që do të ushtrojë Shoqëria nuk asnjë pengesë ligjore dhë si e tillë ajo duhet të pranohet.

K A R A K T E R I :

"e mbështetje të nenit 5 të Ligjit Nr. 7514, datë 1[illegible].8.1991, si dhë të Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Mbi shoqëritë tregtare",

V E N D O S A :

Regjistrimin e personit juridik të Shoqërisë Tregtare Private

me perqendrimi te kufizuar te emerues "ALB - STAR" SHPK, krijuar nga cë
i Sadik Emini, ortak i votës dhe administrator i saj per te ushtruar
aktivitetin tregetar ne fushen e : a d e r t i m i t, shfrytezimit, po
punimit e tregetimit te materialeve te ndertimit, duke pasur per baze
ato te ndertimit te objekteve te ndryshme, perdorimit te materialeve
per instalime elektrike e hidraulike. Shitblerje me shumice dhe pakice,
EKSPORT IMPORT te mallrave te ndryshme industriale, ushqimore, ushqim e
cial, bar - bufe, restorant, konfekcione, tekstile, produkte bujqesore
dhe blegtorale, fruta perime, paleje elektro shtepiake, hidro sanitare,
elektrike, elektronike, hidraulike, artikuj kimike, plastike, lokum,
lende druesore, lende te para gjysem fabrikate, makineri e paleje ai dhe
pjese kembimi per to. Transport mallrash te ndryshme e udhetaresh ai
brenda dhe jashte vendit. Operacione tregetare komisioneria e marketingu
shërbime e operacione bankare, financiare, te kembimit etj. Investime
e pjesemarrje me shoqeri te tjera shqipetare ose te huaja ne fushat te n
ndryshme si ne industri, a d e r t i m, perpunim e shfrytezim te materi
aleve te ndryshme ndertimore, bujqesi, transport, industrine ushqimore,
turizem, hotelieri etj. Punime me materiale te perseritesit. Perdorim ndë
tesash e depoja per magazina etj.

Si dhe çfardo lloj veprimtarie tjetër që do te shikohet e arsyeshme dhe me interes nga Shoqeria Tregetare Private "ALB-STAR" SHPK.

Selia e Shoqerise ndodhet ne qytetin e Patosit, lagja "1 Maj".

Kohe zgjatja e Shoqerise do te jete me nje afat te pa caktuar e mbi 10 (dhjete) vjet.

Kapitali i Shoqerise eshte 100.000 (njeqind) mije leke te reja i ndarë nga ortaku i votës i saj, nga cati SADIK EMINI.

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit.

G J Y K T A R I
(Mirjanë Zadi)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR. .....8918/1...I VENDIMIT

VENDIM I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot ne daten 27/06 2002 une gjyqtari..... I Gjykates se shkalles se pare Tirane, shqyrtova kerkesen dhe aktet dokumentare te paraqitura nga kerkuesi z. Sadik Ismailaj me cilesine e administratorit te shoqerise tregetare ALB-STAR sh.p.k.
Nga shqyrtimi I tyre

KONSTATOVA:

Shoqeria tregetare ALB-STAR sh.p.k. me qender ne Patos FIER eshte njohur si person juridik me vendimin Nr. 8918 te dates 15.02.1995 te gjykates se shkalles se pare Tirane me ortak te vetem z. Sadik Ismailaj I cili eshte njekohesisht dhe administrator I saj Me vendimin Nr. 2 date 08.05.2002 ortaku I vetem z. Sadik Ismailaj ka vendosur qe te pranoje dhe nje ortak tjeter ne kete shoqeri duke I shitur 50% te kuotave te kapitalit gje qe u konkretizua me kontraten e shitjes se kapitalit Nr. 1125 Rep dhe Nr. 292Kol date 15.05.2002
Kerkuesi me cilesine e administratorit kerkon qe ne rregjistrin tregetar prane gjykates se shkalles se pare Tirane te depozitohet vendimi I ortakut te vetem si dhe kontrata e shitjes se kuotave e permendur me lart.
Kerkesa eshte e ligjshme dhe dokumentat e paraqitur jane te rregullta prandaj duhet pranuar.

PER KETO ARESYE:

Mbeshtetur ne ligjin Nr. 7638 date 19.11.1992 " PER SHOQERITE TREGETARE" dhe ligjin Nr. 7667 date 28.01. 1993 ' Per regjistrin tregetar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregetare"

VENDOSA

Te depozitohet ne rregjistrin tregetar vendimi Nr.2 date 08.05.2002 I ortakut te vetem te shoqerise tregtare ALB-STAR sh.p.k qe ben fjale per pranimin e nje ortaku tjeter ne kete shoqeri si dhe kontrata e shitjes se kuotave te kapitalit Nr. 1125 Rep dhe Nr. 292Kol. Date 15.05.2002 I cili ben fjale per shitjen e kuotave ne masen 50% ne favor te z.Idajet Ismailaj duke e bere keshtu bashkeortak ne kete shoqeri tregetare.
Urdherohet zyra e rregjistrit tregetar te beje ndryshimet perkatese ne kolonen ...4.5..... Germa... dhe te ndaje me vije te kuqe rregjistrimet nga njeri tjetri.

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr. 8918/2 Vendimit

VENDIM

I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me date 10/08/05 une Gjyqtare e Gjykates se shkalles se pare Tirane _____ mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesit :

- **Sadik Ismailaj**

per depozitimin prane regjistrit tregtar te vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise tregetare **"ALB-STAR "** sh.p.k. dhe :

KONSTATOVA

Se me vendimin **Nr. 8918,** date 15/02/1995 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregetare **"ALB-STAR "** sh.p.k.

Me vendimin Nr. 1 date 25.05.2005 te asamblese se ortakeve te shoqerise tregetare **"ALB-STAR "** sh.p.k. eshte vendosur :

- Shtimi i kapitalit te shoqerise.
- Caktimi i ekspertit kontabel z.**Hetem Sulaj**.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit **Nr.7638**, date 19.11.1992, te Ligjit **Nr.7667** date 28.01.1993:

VENDOSA

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin prane regjistrit tregtar te vendimit Nr. **1** date 25.05.2005 te asamblese se ortakeve te shoqerise tregetare **"ALB-STAR "** sh.p.k. ku eshte vendosur :

- Shtimi i kapitalit te shoqerise.
- Caktimi i ekspertit kontabel z.**Hetem Sulaj**.

Urdherohet zyra e regjistrit tregtar te beje ndryshimet perkatese ne skeden e shoqerise.

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TE RRETHIT TIRANE
NR.848/3 AKT

VENDIM
I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane, sot me date 27/06/2005, une A. Coco , Gjyqtare e Gjykates se shkalles se pare te rrethit Tirane, pasi mora ne shqyrtim: Kerkesen e Administratorit te te shoqerise tregetare "ALB-STAR"sh.p.k Fier,z.Sadik ISMAILAJ , Vendimin Nr.2 dt. 15.06.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise tregetare "ALB-STAR " sh.p.k Fier :

KONSTATOVA SE:

Shoqeria "ALB-STAR " sh.p.k Fier eshte rregjistruar si Person Juridik me Vendimin e Gjykates se shkalles se pare te rrethit Tirane Nr. 891815.02.1995.
Me vendim nr.2 , dt. 15.06.2005 Asambleja e Ortakeve te shoqerise, ka vendosur :

- Miratimin e Raportit te Ekspertit Kontabel te Autorizuar per zmadhimin e kapitalit te shoqerise nepermjet perfshirjes se rezervave, fitimeve te akumuluara dhe kontributeve ne natyre ;

Dokumentacioni i paraqitur eshte I plote dhe kerkesa e drejte dhe e mbeshtetur ne ligj.

PER KETE ARSYE:

Ne baze te ligjit Nr. 7683 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjit Nr. 7667 dt. 28.01.1993 "Per rregjistrin tregtar",

VENDOSA:

1. Pranimin e kerkeses.
2. Depozitimin e Vendimit nr.2 dt.15.06.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise tregetare " ALB-STAR " sh.p.k Fier .
3. Zmadhimin e kapitalit te nenshkruar te shoqerise nepermjet perfshirjes se rezervave, fitimeve te akumuluara dhe kontributeve nga 100.000 leke te behet 85.000.000 (tetedhjetepesemilion) leke .
4. Te behen ndryshimet perkatese ne rregjistrin tregtar.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykaten e Apelit.

Tirane, me 27/06/2005

GJYQTARE
A. Coco

AKT- THEMELIMI

1

SHOQERIA PRIVATE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "ALB-STAR" SHPK, ORTAK I VETEM DHE ADMINISTRATOR

Une Sadik Ismaili , i biri i Mehmetit, lindur me 5.4.1943 ne qyt etin e Fierit dhe banues ne qytetin e Patosit, ne mbeshtetje te nenit 2 te § 1, shkronja "ç", te Ligjes Nr. 7512, date 10.8.1991 "Per sanksioni min e mbrojtjen e prones private", nismes se lire te veprimtarise privat dhe privatizimit" si dhe te Ligjes Nr. 7638, date 19.11.1992 "Mbi shoqe rite tregetare", vendosa te themelej Shoqerine tregetare Private me per gjegjesi te kufizuar te emertuar "ALB-STAR"; ortak i vetem dhe ADMINIS TRATOR zotin Sadik Ismaili sot me date ___.4.1995 ne qytetin e Patosit.

NENI 1

Formohet Shoqeria Tregetare Private e emertuar "ALB - STAR" SHPK me pergjegjesi te kufizuar, me ortak te vetem themelues, zotin SADIK ISMAILLI; i cili eshte edhe administrator i saj.

NENI 2

Selia e Shoqerise do te jete ne qytetin e Patosit, rrethi Patos

NENI 3

Veprimtaria e Shoqerise do te jete me nje afat te pa caktuar e 10 vjet. Ajo mund te shperbehet ne cdo koho ne rastet e parashikuara n Statutin qe i bashkengjitet ketij Akti Themelues.

NENI 4

Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te jete kryesisht ne fu en e ndertimit te objekteve te ndryshme ndertimore, shfrytezimit, per nimit e tregetimit te materialeve te ndertimit, duke pasur per baze te ndertimit, perdorimit te materialeve per instalime hidraulike, ele ike, shitblerje me shumice dhe pakice, eksport import te mallrave te shme industriale, ushqimore, ushqim social, bar bufe, restorant, konf ione, tekstile, produkte bujqesore dhe blegtorale, fruta perime, paic elektro shtepiake, hidro sanitare, elektriko , elektronike, artikuj k ike, plastike, lekure, lende druesore, lende te para djyesem fabrikate, qineri e paisje si dhe pjese kembimi per to. Transport mallrash te nd shme e udhetaresh si brenda dhe jashte vendit, operacione tregetare k isionarie e marketingu, sherbime e operacione bankare , financiare, kembiesmit etj. Investime e pjesemarrje ne shoqeri te tjera shqipetare ose te huaja si ne industri, ndertim, perpunim e shfrytezim te materi ovev te ndryshme ndertimore, bujqesi, transport, industrine ushqimor punime me materiale te poroositesit. Perdorim ndertesash e deposh per magazina etj.

Si dhe cfardo llloj veprimtarie tjeter qe do te shikohet e are

eshme dhe me interes nga shoqeria.

NENI 5

Kapitali i Shoqerise do te jete 100.000 mije leke te reja i derdhur nga ortaku i vetem i saj, zoti Sadik Ismaili.

NENI 6

Veprimtaria e Shoqerise shtrihet nga 1 Janari deri me 31 Dhjetor te cdo viti. Aktiviteti i pare i saj fillon menjehere me rregjistrimin e saj ne daten e miratuar nga Gjykata e rrethit Tirane dhe mbaron me 31.Dhjetor 1995.

NENI 7

Veprimtaria e Shoqerise realizohet ne baze te leverdises ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancet e saj.

NENI 8

Drejtimi i Shoqerise behet nga ortaku i vetem i saj, nga zoti Sadik Ismaili, qe eshte edhe ADMINISTRATOR i saj i vetem, i cili avendecon Asamblene e ortakove te Shoqerise.

NENI 9

Marredhenjet e punes ne Shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes qe lidhet midis paleve ne mbeshtetje te Ligjes Nr. 7528, date 5.12.1991 "Per marredhenjet e punes" si dhe te Kodit te Punes;

NENI 10

Mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se Shoqerise me te punesuarit apo me tretet kur ato nuk mund te zgjidhen me pajtim o mirekuptim, qeshtja i kalon per kompetence gjykates.

NENI 11

Shperberja e Shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per cfar do shkaku duke vepruar sipas kritereve qe pershkruhen ne Statutin e kesaj Shoqerie.

NENI 12

Shoqeria Tregetare Private me perfjegjesi te kufizuar "ALB -STAR SHPK ka vulen e saj te rrumbullaket me madhesi te zakoneshme me teket per rreth saj.

NENI 13

Shoqeria eshte person juridik shqipetar e do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te Ligjes Nr. 7514, date 10.8.1991 si dhe te Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Mbi shoqerite tregetare private", te Kodit Civil dhe te akteve te tjera ligjore dhe nenligjore te dala ne zbatim te tyre.

NENI 14

Pasuria e Shoqerise mund te sigurohet prane Institutit te Sigurimeve te Shqiperise.

NENI 15

Me Statutin qe i bashkengjitet ketij Akti Themelimi percaktohen kerkesat ligjore kryesore per themelimin e nje shoqerie tregetare private me pergjegjesi te kufizuar, te drejtat dhe detyrat e ortakut te vetem, administratorit etj.

NENI 16

Ky Akt Themelimi perpilohet ne disa kopje per t'iu shperndare organeve kompetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentat baze te Shoqerise Tregetare Private me pergjegjesi te kufizuar "ALB - STAR" SHPK.

Akti i themelimit hyn ne fuqi ne diten e nxjerrjes se tij nga ortaku i vetem themelues e rregjistrimin e tij ne zyren e tatimeve.

Ky Akt Themelimi u perpilua ne Tirane, me 15.2.1995

THEMELUESI I SHOQERISE TREGETARE ORTAK I VETEM

Sadik Ismaili

Tirane, me 15.2.1995

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE
Nr. 681 Rep. 106 Kol.

VERTETIM

Vertetohet se cot me date 15.2.1995 ne zyren e Noterise Tiranes u paraqit zoti Sadik Ismaili i biri i Mehmetit, lindur ne vitin 1943 ne qytetin e Fierit dhe banues ne qytetin e Patosit, me leter njoftimi Nr. AZ 397069, i cili nenshkroi kete Akt themelimi, dhe une noteria pasi e gjeta konforme ligjes e vullnetit te tij e vertetova si me poshte.

NOTERE

NOTERE
NEXHLA REGLEZI

PULLE-TAKSE 10 LEKE REPUBLIKA E SHQIPERISE

S T A T U T

I

SHOQERISE TREGETARE PRIVATE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR E EMERTUAR "ALB-STAR" SHPK

ORTAK I VETEM

Statuti i Shoqerise Tregetare Private "ALB-STAR" SHPK eshte akti baze ku do te mbeshtetet ajo per organizimin e themelimit e te zhvillimit te veprimtarise .

Shoqeria themelohet nga ORTAK I VETEM dhe ADMINISTRATOR zotin SADIK ISMAILI, i biri i Mehmetit, lindur me 3.2.1943 ne qytetin e Fieri dhe banues ne qytetin e Patosit.

KERU I

FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, KOHE ZGJATJA DHE SELIA

NENI 1

Shoqeria formohet ne baze te legjislacionit shqipetar ne fuqi dhe eshte e formes se shoqerive me pergjegjesi te kufizuar (Shoqeri Tregetare Private).

NENI 2

Shoqeria Tregetare Private eshte e emertuar "ALB - STAR" SHPK.

NENI 3

Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te jete kryesisht ne fushen e Ndertimit, shfrytezimit, perpunimite e tregetimit te materialeve te ndertimit, duke pasur per baze ate te ndertimit te objekteve te ndryshme, perdorimit te materialeve per instalime hidraulike e elektrike. Shitblerje me shumice dhe pakice, EKSPORT IMPORT te mallrave te ndryshme industriale, ushqimore, ushqim social, bar bufe, restorant, konfeksione, tekstile, produkte bujqesore dhe blegtorale, fruta perime; paisje elektro shtepiake, hidro sanitare, elektrike, elektronike, artikuj kimike, plastike; lekure, lende drusore, lende te para gjysem fabrikate, makineri e paisje si dhe pjese kembimi per to. Transport mallrash te ndryshme e udhetaresh si brenda edhe jashte vendit. Operacione tregetare bankare, financiare, te kambizmit etj. Investime e pjesemarrje me shoqeri te tjera shqipetare e te huaja ne fusha te ndryshme si ne industri, ndertim, perpunim e shfrytezim te materialeve te ndryshme ndertimore, bujqesi, transport, industrine ushqimore, turizem, hoteleri etj. Punime me materiale te porositesit. Perdorim ndertesash e deposh per magazina etj.

Si dhe cfardo lloj veprimtarie tjeter qe do te shikohet me interes nga Shoqeria Tregetare Private "ALB - STAR" SHPK.

NENI 4

Per kryerjen e veprimtarise se saj Shoqeria do te hapi aktivitet per shfrytezimin e materialeve te ndertimit, lendes se pare per to, she bime tregetuese si dhe te bashkepunoje me persona fizike e juridike vendas e te huaj.

NENI 5

Selia e Shoqerise do te jete me qender ne Patos te rrethit Patos Lagja "1 Maj". Shoqeria do te jete me qender ne Patos. Ajo mund te hapi edhe vend qendrime te tjera te dyta, por aktiviteti i saj do te kryhet ne te gjithe teritorin e R.SH. ne menyre ambulatore, me njesi apo mund te çeli edhe zyra , perfaqesi, axhensi apo filiale. Me miratim te organeve kompetente mund te hapi qender edhe jashte vendit.

Çdo ndryshim i selise do te behet me vendim te ortakut te vetem dhe Administrtorit te Shoqerise, zotit SADIK ISMAILI.

NENI 6

Kohe zgjatja e Shoqerise do te jete me nje afat te pa caktuar e mbi 10 vjet. Ajo mund te shperbehet ne çdo kohe dhe per çfardo shkaku me vendim te ortakut te vetem te saj.

KREU II

KAPITALI THEMELOR, KONTRIBUTET DHE PJESET E KAPITALIT THEMELOR

NENI 7

Kapitali fillestar themelor i Shoqerise do te jete 100.000 (njeqind) mije leke te reja i derdhur nga ortaku i vetem i saj, zoti SADIK ISMAILI, kapital i cili eshte derdhur ne Banken e Shtetit kundrejt konformes bankare. Ortaku i vetem e nenshkruan dhe e shlyen kete kapital plotesisht.

Me vendim te ortakut te vetem kapitali i derdhur mund te rritet ose te zvogelohet, por nuk mund te ulet nen kufirin e 100.000 (njeqind) mije lekeve.

NENI 8

I gjithe kapitali eshte i ndare ne 100 pjese te barabarta per sejcilen pjese, prej 1.000 LEKESH . Te gjitha pjeset e kapitalit jane vene nga ortaku i vetem, zoti SADIK ISMAILI, i cili e nenshkruan e shlyen plotesisht kete kapital.

NENI 9

Pjeset e kapitalit themelor jane plotesisht te transferueshme ne rruge trashegimie ne rast ndarjeje pasurore midis bashkeshorteve si dhe midis paraardheseve dhe pasardheseve.

Pjeset e kapitalit mund t'u transferohen personave te tjere qe nu bejne pjese ne shoqeri, por gjithmone me vendim te ortakut te saj te vetem.

NENI 10

Fitimi i realizuar nga ushtrimi i aktivitetit ekonomik te Shoqerisë se do te administrohet nga ortaku i vetem i saj. Nje pjese e ketij kapitali mund te perdoret per zgjerimin e aktivitetit tregetar. Shoqeria eshte e detyruar te shlyeje te gjitha detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe te treteve.

NENI 11

Shoqeria tregetare Private "ALB - STAR" eshte disponuese dhe perdoruese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje dhe te shfrytezoje te drejta te tjera materiame ose jo materiale duke perfshire edhe te drejten per te shitur pasurine e vete tek te tertet.

KREU III

MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQERISË

NENI 12

Te gjitha vendimet merren nga ortaku i vetem, i cili zvendeson Asamblene e Shoqerise, zoti SADIK ISMAILI, i cili eshte edhe ADMINISTRATOR i Shoqerise. Themeluesi i Shoqerise ka ne kompetence te caktoje si Administrator edhe persona te tjere, pamvaresisht se nuk kane cilesine e ortakut.

NENI 13

Administratori ka per detyre organizimin dhe drejtimin e veprimtarise se Shoqerise. Ai mund te kryeje te gjitha veprimet e administrimit ne interes te Shoqerise.

NENI 14

Ne marredhenje me tretet Administratori e angazhon Shoqerine nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

NENI 15

Ortaku themelues ka ne kompetence per te marre vendime si :

Te miratoje programin e Shoqerise, te hartoje raportin e administrimit, inventaret dhe llogarite vjetore. Vendos per shperndarjen e Shoqerise, per ndarjen e fitimit dhe mbulimin e humbjeve. "rregullon marredhenjet e punesimit dhe te shperblimit brenda Shoqerise, emerimin e shkarkimin e administratoreve, eksperteve kontabel, ndryshimin ne Statut dhe ne Aktin e Themelimit, per zvogelimin ose zmadhimin e kapitalit, kalimin e kapitalit te treteve, ndryshimin e kohes se punes e veprimtarise se se firmes, shndrimin e saj ne nje forme tjeter si dhe likuidimin e vete Shoqerise. Sipas akteve ligjore ne fuqi ben shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve shteterore, personave juridike e fizike, vendas e te huaj.

NENI 16

Shoqeria mban dokumentacion te plote per veprimtarine ekonomiko

financiarei pasqyrin ato ne kontabilitet dhe ne bilancet e saj konforme legjislacionit perkates.

NENI 17

Ortaku i vetem perballon humbjet qe pesoh Shoqeria deri ne kufirin e vleres se kapitalit themelor.

NENI 18

Administratori ka te drejte te informohet per veprimtarine r Shoqerise si dhe te njihet me dokumentat e saj dhe llogarite perkatese ne rast se keto mbahen nga persona te tjere te caktuar prej tij.

NENI 19

Administratori e humbet detyren e tij ne rastin e prishjes se Shoqerisesi dhe kur eshte i zgjedhur shkarkohet nga ortaku themelues.

NENI 20

Ortaku themelues eshte pergjegjes individualisht ose solidarisht simbas rastit ndaj Shoqerise ose te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te Statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te Shoqerise.

NENI 21

Kontrolli financiar i Shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar dhe i emeruar me nje afat prej tre vjetesh financiare e me mundesi rrizgjedhjeje nga ortaku i vetem.

KREU IV

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE DHE REZERVA E DOMOSDOSHME

NENI 22

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor perjashtuar vitin e pare qe si date fillimi konsiderohet ajo e rregjistrimit . llogarite vjetore, inventari, raportet dhe pperacionet financiare te vitit te hartuara nga administratorët apo ekspertet kontabel miratohen nga ortaku i vetem.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine financiare vjetore behet brenda nje afati tre mujor mbas mbylljes se vitit financiar, ndersa miratimi i programit per vitin e ardheshem behet ne fund te vitit.

NENI 23

Mbas miratimit te llogarive vjetore dhe te evidentimit te ekzistences se fitimit, ortaku i vetem vendos zbritjen nga fitimi per krijimin e fondit te erzerves ligjore, te kapitalit dhe te erzerevave te tjera si dhe perdorimin e pjeses tjeter te fitimit.

NENI 24

Shoqeria mund te lidhe kontrate me sektoer shtetrore drejtperdrejt ne tregun e lire si dhe me persona fizike e juridike vendas e te huaj.

NENI 25

Ne veprimet kontraktuale Shoqeria perfaqesohet nga ortaku i vete ose persona te tjere te caktuar prej tij. Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per shoqerine.

NENI 26

Shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal, afatet e derdhjes se tij, sigurimet shoqerore etj. Ajo ka te drejte te çele llogari likujduese prane bankave te vendit si dhe te kryeje veprime likujduese nepermjet tyer.

NENI 27

Per sigurimin e veprimtarise ekonomike Shoqeria ka te drejte te vetefinancohet ne leke ose ne valute te huaj. Shkembimin e monedhes shqipetare ne monedhe te huaj dhe anasjelltas mund ta beje ne perputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shqipetar ose ne tregun e lire privat te valutes.

NENI 28

Per pasqyrimin e aktivitetit privat Administratori ose persona te tjere te caktuar prej tij jane te detyruar te mbajne dokumentacion te rregullte financiar dhe regjistrat perkates sipas ligjeve per kontabilitetin.

NENI 29

Veprimet ekonomike e Shoqerise mbaron ne muajin Dhjetor te çdo viti. Administratori apo persona te tjere te caktuar prej tij jane te detyruar te paraqesin bilancin vjetor dhe deklaraten e te ardhurave dhe te depozitoje ne organet financiare te juridiksionit perkates.

KREU V

MARREDHENJET E PUNES NE SHOQERI

NENI 30

Ortaku themelues vendos per shtimin ose pakesimin e numrit te ortakeve dhe te personave te tjere te punesuar ne veprimtarine e Shoqerise.

NENI 31

Marredhenjet e punesimit brenda Shoqerise rregullohen sipas kontrates se punes qe lidhet midis paleve ne perputhje me legjislacionin shqipetar ne mbeshtetje te Ligjes Nr. 7526, date 3.12.1991 "Per marredhenjet e punes".

NENI 32

Marrja ne pune behet me rregjistrimin e punonjesit nga punedhenes ne librin e punes te Shoqerise si dhe duke njoftuar organet perkatese te

juridiksionit ku ushtron aktivitetin Shoqeria.

NENI 33

Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punes behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga ortaku i vetem themelues i shoqerise. Largimi lidhet me mbarimin e kontrates se punes, per shkak te shkeljes se disiplines ose me kerkesen e vete te interesuarit.

NENI 34

Largimi nga Shoqeria behet mbasi jane shlyer detyrimet materiale dhe monetare.

KREU VI

DISPOZITA TE TJERA TE PERGJITHESHME

NENI 35

Shoqeria mund te prishet para afatit te percaktuar ne kete Statut kur ndryshon afati ose kur ka nje prishje te detyrueshme te parakoheshme per shkaqe te ndryshueme.

NENI 36

Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi emerohen nje ose me shume likuidatore te cilet ne perfundim paraqesin nje raport mbi rezultatet e likujdimit te Shoqerise.

Ortaku i vetem themelues ben miratimin perfundiltar te procesit te likujdimit dhe vendos per heqjen e mandatit te likujdatorit.

NENI 37

Pasi shlyen te gjitha detyrimet qe Shoqeria iu ka te treteve , personave juridike e fizike, behet njoftimi i mbylljes ose i likujdilit duke kryer formalitet perkatese duke çregjistruar shoqerine nga rregjistri Tregetar prane Gjykates Tirane.

NENI 38

Ndryshimi i Shoqerise ne nje shoqeri tjeter behet me vendim te ortakut te vetem kur plotesohen kushtet per krijimin e shoqerive te llojeve te tjera.

NENI 39

Te gjitha mos marreveshjet qe mund te lindin ndermjet shoqerise dhe te punesuarve apo personave te trete kur ato nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, zgjidhja e tyere mbetet ne kompetence te gjykates qe shqyrton çeshtjen.

NENI 40

Çeshtjet e tjera qe nuk jane trajtuar ne kete Statut, gjitheshka i referohet Ligjes Nr. 7638, date 19.11.1992 "Mbi shoqerite tregetare" ne veçanti, si dhe legjislacionit shqipetar ne fuqi. Gjithashtu edhe akteve te tjera ligjore e nenligjore.

NENI 41

Themeluesi i Shoqerise ne çdo kohe mund te beje ndryshime e plotesime ne Statut pa rene ndesh ne menyre thelbesore me nenet qe jane pershkruar ne kete Statut.

NENI 42

Ndryshimet e plotesimet e ketij Statuti behen ne te njejten menyre e procedure me te cilen miratohet vete Statuti.

NENI 43

Shoqeria ka vulen e saj te rrumbullaket me madhesi te zakoneshme perreth saj shkruhet emri dhe vend ndodhja e Shoqerise.

NENI 44

Ky Statut perpilohet ne disa kopje per t'u shperndare organeve kompetente, ndersa nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te Shoqerise

Statuti u hartua ne Tirane me date 14.2.1995

ORTAKU I VETEM THE ELUES E ADMINISTRATO
SADIK ISMAILI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE
Nr. 680 Rep. 105 Kol.

Tirane, me 15.2.1995

VERTETIM

Vertetohet se sot me date 15.2.1995 u paraqit personalisht ne Zyren e Noterise Tirane zoti Sadik Ismaili, i biri i Mehmetit, lindur me 3.2.1943 ne qytetin e Fierit dhe banues ne qytetin e Patosit, me leter njoftimi Nr. AZ 397069, i cili nenshkroi kete Statut dhe une no ia pasi e gjeta konforme ligjes dhe vullnetit te tij e vertetova. si poshte.

NOTERE

PULLE TAKSE 10 LEKE REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERE NEXHLA KOLLCZI

8P18

K E R K E S E

E

KERKUESI : Sadik Ismaili, i biri i Mehmetit, lindur me 3.2.1943, ne qytetin e Fierit dhe banues ne qytetin e Patosit, Lagja "1 Maj", madhor dhe i afte per te kryer veprime juridike.

OBJEKTI: Rregjistrimin e personit Juridik te Shoqerise Tregetare Private "ALB - STAR" me baze re nenit 5 te Ligjes Nr. 7512, date 10.8.1991, si dhe te Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992.

Eshte regjistruar me vendim nr. 15, d. 9.9.93

P E R P A R A

GJYKATES SE RRETHIT

T I R A N E

Ne mbeshtetje te nenit 5 te Ligjes Nr. 7512, date 10.8.1991, si dhe te Ligjes Nr. 7638, date 19.11.1992 "Mbi shoqerite Tregetare Privat kerkoj te rregjistrohem si person juridik te Shoqerise Tregetare Privat me pergjegjesi te kufizuar, te emertuar "ALB - STAR", per te ushtruar aktivitetin tregetar privat si ortak i vetem dhe Administrator i saj ne fushen e Ndertimit. Shitblerje me shumice dhe pakice, eksport import te mallrave te ndryshme industriale, ushqimore, ushqim social, bar-bufe restorant, konfeksione, tekstile, produkte bujqesore dhe blegtorale, fruta perime, paisje elektro shtepiake, hidro sanitare, elektronike, ai ikuj kimike, plastike, lekure, materila ndertimi, lende drusore, lende te para gjysem fabrikate, maqineri e paisje e pjese kembimi per to. Tregetim automjetesh te ndryshme e pjese kembimi per to. Transport mall rashte te gjitha llojeve dhe udhetaresh brenda dhe jashte vendit. Opera cione teregetare, komisionarie e marketingu. Sherbime e operacione ban are, financiare, te kambizmit etj. Investime e pjesemarrje ne investime me shoqeri te tjera shqipetare apo te huaja ne fusha te ndryshmesi ne industri, ndertime, bujqesi, industrine ushqimore, transport, turizem, hoteleri etj. Punime me materile te porositesit, perdorim ndertesash e deposh per magazinim etj.

Si dhe çfar do llloj veprimtarie tjeter qe do te shikohet me int es nga Shoqeria.

Selia e Shoqerise do te jete ne qytetin e Patosit Lagja "1 Maj" Kapitali i Shoqerise eshte 100.000 (njeqint) mije leke te reja, i derd ur nga ortaku i vetem i saj, zoti Sadik Ismaili.

Shoqeria do te kete nje kohe zgjatje me nje afat te pa caktuar mbi 10 vjet.

Kerkesa e ime eshte e mbeshtetur ne ligje dhe si e tille duhet pranohet nga ana e asaj Gjykate.

K E R K U E S I
SADIK ISMAILI

FIER me 15.05. 2002

KERKESE

Kerkues: Sadik Mehmet Ismailaj lindur me 03-02-1943 banues ne lagjen Apollonia Fier

Objekti: Kerkoj depozitimin e vendimit nr.2 date 08-05-2002 te ortakut te vetem te shoqerise tregtare ALB-STAR sh.p.k si dhe te kontrates se shitjes se kuotave date 15.05 2002

Baza ligjore: Ligji 7638 date 19-11-1992 "per shoqerite tregtare " dhe ligji 7667 date 28-01-1993 "per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare"

Gjykates se shkalles se pare te rrethit Tirane

Une kerkuesi Sadik Ismailaj jam ortak i vetem dhe administrator I shoqerise tregtare ALB-STAR sh.p.k me seli ne Patos Fier e cila eshte e njohur si person juridik me vendimin nr.8918 date 15-02-1995 te Gjykatese shkalles se pare te rrethit Tirane .
Me vendimin nr.2 date 08-05-2002 ortaku I vetem zoti Sadik Ismailaj ka vendosur ti shese 50% te kuotave te kapitalit zotit Idajet Ismailaj duke u bere keshtu bashkortake ne pjese te barabarta nga 50% secili, gje qe u konkretizua me kontraten e shitjes se kuotave date 15.05. 2002. Ne keto kushte kerkohet te depozitohet vendimi I ortakut te vetem dhe kontrata perkatese e shitjes se kuotave .
Bashkelidhur nga nje kopje e secilit dokument te shenuar me larte

KERKUES
Sadik Ismailaj

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE FIER
Nr 1127 rep

VERTETIM

Sot me date 15.05. 2002 para meje noterit Kovac Duraj u paraqit zoti Sadik Ismailaj i datelindjes 1943 banues ne lagjen Apollonia Fier I njohur me leternjoftimin AZ Nr.397069 me zotesi te plote juridike per te vepruar .Ai deklaroi se kete akt e ka perpiluar vete dhe e nenshkruan me vullnet te lire para meje noterit.

PULLE TAKSE 50 LEKE R.SHQIPERISE
PULLE TAKSE 50 LEKE R.SHQIPERISE

NOTERI
Kovac Duraj

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SH.P.K ALB-STAR

Fier me 08-05-2002

VENDIM I ORTAKUT TE VETEM
Nr 2

Une Sadik Ismailaj jam ortak I vetem I shoqerise tregtare ALB-STAR si dhe administrator I saj Kjo shoqeri eshte rregjistruar prane rregjistrit tregtar te Gjykates se Shkalles se Pare te Rrethit Gjyqesor Tirane me vendimin Nr.8918 date 15-02-1995 .

Pasi studiova veprimtarine e kesaj shoqerie konkludova se per te shtuar aktivitetin e shoqerise duhet pranuar dhe nje ortak tjeter , konkretisht z. Sadik Ismailaj I cili ka bere kerkese per tu pranuar si ortak ne kete shoqeri.

Per keto arsye vendosa :

1. Te pranoj ortak te sh.p.k ALB-STAR zotin Idajet Ismailaj
2. Te behet kontrata perkatese e shitjes se kuotave te kapitalit
3. Te depozitohet ne rregjistrin tregtar prane Gjykates se Shkalles se Pare te Rrethit Gjyqesor Tirane

ORTAKU I VETEM
Sadik Ismailaj

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE FIER
Nr 1126 REGJ

VERTETIM

Sot ne daten 15.05. 2002 para meje noterit Kovac Duraj u paraqit personalisht zoti Sadik Ismailaj I datelindjes 03-02-1943 , banues ne Fier , I njohur prej meje personalisht me zotesi te plote juridike per te vepruar I cili me deklaroi se e ka nenshkruar me vullnet te lire kete document.

Une noteri e vertetoj kete akt rregullisht.

REPUBLIKA E SHQIPERISE KOVAC XH. DURAJ NOTER FIER

PULLE TAKSE 50 LEKE R.SHQIPERISE
PULLE TAKSE 50 LEKE R.SHQIPERISE

NOTERI
Kovac Duraj

SHOQERIA TREGETARE "ALB-STAR " SH.P.K
SELIA :KTHESA E PATOSIT; PATOS,FIER

Fier , me: 25.05.2005

KERKESE

Kerkuesi: Shoqeria tregetare " ALB-STAR " sh.p.k Fier , rregjistruar si Person Juridik prane Gjykates se shkalles se pare te rrethit Tirane me Vendim Nr.8918 date 15.02.1995, perfaqesuar nga Administrator z. Sadik ISMAILAJ.

Objekti: Depozitimi ne regjistrin tregetar te vendimit te Asamblese se Ortakeve te te shoqerise "ALB-STAR"sh.p.k z. Sadik ISMAILAJ , nr.1 dt.25.05.2005.

Caktimi i Ekspertit Kontabel te Autorizuar Z.Hetem SULAJ per vleresimin e kapitalit te shoqerise dhe zmadhimin e tij , nepermjet kontributeve ne natyre , te verifikimit te elementeve te aktivit dhe te pasivit te bilancit ,te perfshirjes te fitimeve te akumuluara te shoqerise .

Baza Ligjore: Neni 62-63 i ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare".

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE TE RRETHIT TIRANE

Z. Kryetar!

Shoqeria " ALB-STAR " sh.p.k Fier, eshte rregjistruar si Person Juridik prane Gjykates se shkalles se pare te rrethit Tirane me Vendim Nr. 8918 date 15.02.1995.

Gjate kesaj periudhe, ortaket e shoqerise kane bere investime te konsiderueshme ne natyre duke rritur asetet e shoqerise te cilat kerkone t'i pasqyroje ne rritjen e kapitalit themeltar.

Ne daten 25.05.2005, Asambleja e Ortakeve te shoqerise " ALB-STAR"sh.p.k , Fier , me Vendimin Nr.1 te saj ka vendosur te zmadhoje kapitalin themeltar te shoqerise nepermjet kontributeve ne natyre dhe nga fitimi I akumuluar .

Per kete qellim, mbeshtetur ne nenin 62 - 63 te ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", me qellim vleresimin e ketyre kontributeve, me Vendimin Nr.1 date 25.05.2005, Asambleja e Ortakeve te shoqerise ka vendosur t'i drejtohen Gjykates se shkalles se pare te rrethit Tirane me kerkesen per caktimin e z. Hetem SULAJ , Ekspert Kontabel I Autorizuar , mbajtes I licenses 017 dt.10.02.200 te IEKA , me cilesine e Ekspertit te Kontributeve.

Bashkengjitur kesaj kerkese po ju paraqesim:

1. Vendimin nr.1 date 25.05.2005 te Asamblese se Ortakeve te shoqerise tregetare "ALB-STAR" sh.p.k .

ADMINISTRATOR

Sadik ISMAILAJ

Ndërtim Imp Exp ALB STAR Fier Albania

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE Tirane
NR. 816 REP.
NR. _____ KOL.

VERTETIM

Ne Tirane, sot me date 08.06/2005, ne zyren e noterise , para meje Notere Si merko me adrese ne rrugen " Sh- Ribuqo ", u paraqit personalisht z. Sadik ISMAILAJ, lindur ne _____, me __/__/____, me cilesine e Administrator I shoqerise tregetare " ALB-STAR "sh.p k., mbajtes I pasaportes me nr._____ i njohur prej meje personalisht, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili deklaroi se sa me siper eshte hartuar ne perputhje me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe une notere e vertetoj nenshkrimin e tij rregullisht sipas ligjit.

NOTERE

PULLE TAKSE
PULLE TAKSE
100 LEKE
REPUBLIKA E SHQIPERISE

SHOQERIA TREGETARE " ALB-STAR " SH.P.K

SELIA : KTHESA E PATOSIT ; PATOS , FIER

VENDIM NR.1
I
ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE

Sot, ne daten 25.05.2005, ne seline e shoqerise tregetare "ALB-STAR " Sh.p.k. me adrese : Kthesa e Patosit ; Patos , Fier , Asambleja e Ortakeve e kesaj shoqerie , e perbere nga zoterinjte :

1. Sadik ISMAILAJ
2. Idajet ISMAILAJ

-Pasi mori ne shqyrtim bilancin e vitit ushtrimor 2004 , mbyllur me 31.12.2004 si dhe raportin e ekspertit kontabel te autorizuar ;

Ne perfundim , Asambleja e Ortakeve te shoqerise :

VENDOSI:

1. Te miratoj te dhenat e bilancit financiar per ushtrimin e vitit 2004 si dhe rezultatin ushtrimor te ketij viti .
2. Te zmadhohet kapitali nepermjet kontributeve ne natyre .
3. Te caktohet Ekspert Kontabel I Autorizuar z.Hetem SULAJ ,mbajtes I licenses nr.017 date.10.02.2000 te I E K A .

I kerkoj Gjykates depozitimin e ketij vendimi ne regjistrin tregetar .

Tirane , me 25.05.2005

PER SHOQERINE " ALB-STAR " SH.P.K
ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Sadik ISMAILAJ

Idajet ISMAILAJ

Ndërtim Imp Exp ALB STAR Fier Albania

Ortakeve te shoqerise Tregetare " ALB-STAR "Sh.p.k ,Fier .

Zonja e Zoterinj !

Me vendim te gjykates Tirane , nr. 8918/2 dt.10.06.2005 , I marre ne baze te kerkeses se Administratorit tuaj I cili eshte shprehur me vendim nr.1 dt.25.05.2005 , ne kuadrin e projektit per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise tuaj , kam qen caktuar si ekspert ne kete mision sipas ligjit " Per shoqerite tregetare " , 7638 dt. 19.11.1992 .
Une kam nderin tu raportoj Juve per ekzekutimin e ketij misioni , I cili konsiston ne vleresimin e vlerave te pasurise qe perbejne aktivin e shoqerise , dhe verifikimin qe shuma e kapitaleve te veta eshte te pakten me ate te kapitalit themeltar .
Per kryerjen e ketyre misioneve ne kemi disponuar bilancin e shoqerise te hartuar per dt.31.12.2004 , date e mbylljes se ushtrimit te fundit dhe te ekspertuara nga ana e jone , si dhe dokumente te tjera te nevojshme per kontrollin e elementeve te ketyre bilanceve .
Kontrollet tona u kryene ne seline e shoqerise , ne Fier , ku hartohen bilancet dhe dokumntat kontabel dhe na u dhane spjegime dhe justifikime plotesuese per elementete e bilanceve te shqyrtuara si dhe per evoluimin e situates se shoqerise qysh nga data e mbylljes se ushtrimit financiar te fundit .
Ne baze te hapave te ndermara e te punes se kryer , ne jemi ne gjendje tu bejme te njohur perfundimet qe vijojne ne kuadrin e raportit te parashikuar nga ligji .

A-VLERA E PASURIVE QE PERBEJNE AKTIVIN E SHOQERISE

Per shkak te natyres se operacionit te projektuar misioni I yne I verifikimit konsistonte nevojshmerisht per te vleresuar jo aq peshen (rendesine , materialitetin) e plus vlerave eventuale te fshehta (latente) se sa per tu siguruar qe vlerat kontable per te cilat antaret jane thirrur te marrin nje vendim nuk cojne , ne fakt , ne nje mbivleresim te pasurise se shoqerise .

Aktivi I shoqerise I pasqyruar ne bilanc perbehej nga elemente qe vijojne :

Aktive te Qendrueshme	126.428.480 Leke
Aktive Qarkulluese	247.561.785 Leke
Shuma	373.990.265 Leke

Ne kunderparti :

Detyrime te kerkueshme deri ne nje vit	284.586.796 Leke
Detyrime te kerkueshme pas me shum se nje vit	= = = Leke
Shuma	284.586.796 Leke

Aktivi neto kontabel rezulton keshtu :

373.990.265 – 284.586.796 = 89.403.469 Leke

Kapitalet e veta	89.403.469 Leke nga kjo :
Kapitali Themeltar	89.403.469 Leke

Sa me siper kapitali themeltar rezulton si me poshte :

Kapitali I nenshkruar	85.000.000 Leke
Rezerva ligjore	4.403.469 Leke

Vleresimi I cdo posti te aktivit dhe pasivit ka qene objekt te nje shqyrtimi te vemendshem ne kushtet e paraqitura me poshte :

AKTIVET E QENDRUESHME

Elementet e trupezuar . Keta elemente jane detajuar ne anekset e bilancit te 31 dhjetorit 2004 qe ne I kemi lidhur raportit tone . Shqyrtimi (verifikimi) ne te cilen kemi proceduar ka te beje me justifikimin e blerjeve te kryera dhe ekzistencen e pasurive te Aktiveve te Qendrueshme te Trupezuara .
Aktivet e Qendrueshme te Trupezuara jane pasqyruar ne bilanc me koston historike , korrigjuar me amortizimin dhe me vleren e tyre neto . Per sa I perket AQT-ve dhe permirsimeve (rregullimeve) te kryera , si dhe makinerive dhe elemente te tjere te trupezuar te shfrytezimit , ne u siguruam qe amortizimet jane llogaritur e rregjistruar rregullisht . Vlera neto kontable gjenden ne menyre te pergjithshme ne nivelin ose poshte nivelit te vlerave te dobishmerise ose te vijimesise se shfrytezimit .

Per verifikimin dhe vleresimin e tyre u bene sondazhe ne dokumenta kontabel te shoqerise sipas elementeve dhe klasifikimit te tyre dhe rezulton se vlera kontable neto prej 126.418.780 Leke perben nje aktiv real ndaj meret ne konsiderate per zmadhimin e kapitalit te shoqerise .

AKTIVET QARKULLUESE

Aktivet qarkulluese perbehen :

- Gjendje te inventarit dhe ne proces	1.537.660 Leke
- Kerkesa per arketim mbi debitoret	121.906.804 Leke
- Likujditete dhe vlera arke	124.117.321 Leke
Shuma	247.561.785 Leke

Vleresimi I stokut me 31.12.2004 , eshte bere konforme ligjit per kontabilitetin , dhe vlera e pasqyruar ne aktiv te bilancit perputhet me inventar fizik dhe kontabel te bera nga shoqeria me 31.12.2004 per 1.537.660 Leke , e cila perben nje aktiv real per shoqerine per zmadhimin e kapitalit .
Kerkesa per arketim mbi debitoret per 121.906.804 Leke , ekzistojne dhe jane te arketueshem duke qene nje vlere pasurore aktuale per shoqerine tregetare .
Likujditetet per 124.117.321 Leke te pasqyruar ne bilancin perkates , rezultojne se ajo perputhet me konfirmimin bankar per 122.533.173 Leke dhe inventarin fizik te monedhes ne arke per 1.584.148 Leke me 31.12.2004 .

Si konkluzion , vlera neto kontabile qe duhet te merret ne konsiderate per zmadhimin e kapitalit rezulton : 373.990.265 Leke .

DETYRIMET

Ne verifikimin e kryer ne rubrikat e bilancit detyrime per vleren 284.586.796 Leke , rezuton se ajo perbehet nga :

- Detyrime te kerkueshme per nje vit	284.586.796 Leke
Shuma	284.586.796 Leke

Shqyrtimi (verifikimi) I posteve te pasiveve te kerkueshme (detyrime) nuk ka nxjerre asgje jonormale , duke patur parasysh qe deri ne daten e nderhyrjes tone , nuk morem dijeni per ndonje konflikt ose rrezik te mundshem per te ndryshuar situaten e shoqerise .

PERFUNDIMI

Ne perfundim te verifikimeve te bera dhe duke patur parasysh hollesite e dhena me siper ne cmojme qe vlera neto kontabile e elementeve qe perbejne aktivin e shoqerise , ashtu sic dalin keto vlera nga pasqyrat financiare qe I jane aneksuar ketij raporti , jane ne pajtueshmeri me rregullat dhe parimet kontabel ne fuqi dhe perbejne nje vleresim normal dhe te arsyeshem .

B-KAPITALET E VETA DHE KAPITALI THEMELTAR

Per percaktimin e vleres per zmadhimin e kapitalit themeltar eshte ndjekur metoda e vleres neto kontabel , qe llogaritet nga aktivi real duke zbritur detyrimet aktuale te saj .

- Aktivet neto kontabile	373.990.265 Leke
- Detyrimet aktuale	284.586.796 Leke
- Kapitalet e veta	89.403.469 Leke
- Kapitali Themeltar	89.403.469 Leke

Sa me siper kapitali themeltar rezulton si me poshte :

- Kapitali I nenshkruar	85.000.000 Leke
- Rezerva ligjore	4.403.469 Leke

KONKLUZION

Kapitali I nenshkruar I shoqerise me vendim gjykate nr.8918 dt. 15.02.1995 ishte 100.000 Leke dhe me vleresimet tona , bazuar ne legjislacionin perkates behet 85.000.000 (Tetedhjetepesemilion) Leke .

Per te qene ne pajtim me ligjin , **ne vertetojme** se shuma e kapitaleve te veta te shoqerise , e cmuar ne baze te dokumentave per gjendjen me 31.12.2004 te cilat na u komunikuan dhe ne I verifikuam eshte me I larte nga ajo e kapitalit themeltar te shoqerise te percaktuar me vendim gjykate nr.8918 dt. 15.02.1995 .

Tirane , me 15.06.2005

EKSPERT KONTABEL I AUTORIZUAR

Hetem SULAJ

Ekspert Kont. i Autorizuar
HETEM SULAJ
TIRANË ALBANIA
NR Lic 017

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA E TIRANES
Nr. 622 Rep

Tirane ,me 15.06.2005

VERTETIM

Vertetohet se raporti i ekspertit kontabel per rritjen e kapitalit te shoqerise u nenshkrua ne prezencen time nga eksperti hetem sulaj per indetitetin e te cilit u sigurova nga dokumenti indetifikues dhe une notere e vertetoj sipas ligjit.

PULLE TAKSE
100 LEKE
U LIRUJDUR

Notere

3 A Caco 23 06 2005

KERKESE

KERKUESI Sadik Ismailaj administrator i shoqerise tregetare " ALB STAR " SHPK banues ne Fatos Fier.

OBJEKTI Depozitimin prane rregjistrit tregetar te Gjykates te vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise tregetare " ALB STAR " SHPK

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE

TIRANE

Me vendimin nr. 8918 date 15.02.1995 eshte rregjistruar si person juridik shoqeria tregetare " ALB STAR " SHPK.

Me vendimin nr. 8918/2 eshte vendosur : zmadhimi i kapitalit te shoqerise. Caktimi i ekspertit Heten Sulaj.

Me vendimin nr. 2 date 15.06.2005 eshte vendpsor: Miratimi i raportit te ekspertit kontabel te autorizuar per zmadhimin e kapitalit nga 100.000 leke behet 85.000.000 leke.

Depozitimin e ketij vendimi prane rregjistrit tregetar.

KERKUESI
SADIK ISMAILAJ

REPUBLIKA E SHAIPERISE
NOTERIA E TIRANES
Nr. 4224 Rep

Tirane ,me 15.06.2005

VERTETIM

Vertetohet se kerkesa e paraqitur nga kerkuesi per depozitimin e vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise tregetare " ALB STAR " SHPKu nenshkrua ne prezencen time nga kerkuesi Sadik Ismailaj per indetitetin e te cilit u sigurova nga dokumenti indetifikues dhe une notere e vertetoj sipas ligjit.

Notere

PULLE TAKSE
100 LEKE
REPUBLIKA E SHQIPERISE

SHOQERIA TREGETARE " ALB-STAR " SH.P.K

SELIA : KTHESA E PATOSIT ; PATOS , FIER

VENDIM NR.2
I
ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE

Sot, ne daten 15.06.2005, ne seline e shoqerise tregetare "ALB-STAR " Sh.p.k. me adrese : Kthesa e Patosit ; Patos , Fier , Asambleja e Ortakeve e kesaj shoqerie , e perbere nga zoterinjte :

1. Sadik ISMAILAJ
2. Idajet ISMAILAJ

-Pasi mori ne shqyrtim:

1. **Aprovimin e Raportit te Ekspertit Kontabel te Autorizuar z. Hetem SULAJ per zmadhimin e kapitalit nepermjet perfshirjes se rezervave , fitimeve te akumuluara dhe kontributeve ne natyre te shoqerise .**

Ne perfundim , Asambleja e Ortakeve te shoqerise :

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit te Ekspertit Kontabel te Autorizuar per zmadhimin e kapitalit te shoqerise nepermjet perfshirjes se rezervave , fitimeve te akumuluara dhe kontributeve ne natyre .
2. Zmadhimin e kapitalit te nenshkruar te shoqerise nepermjet perfshirjes se rezervave , fitimeve te akumuluara dhe kontributeve nga **100.000 Leke ne 85.000.000 Leke** , sipas raportit te Ekspertit te Kontributeve .

I kerkoj Gjykates depozitimin e ketij vendimi ne regjistrin tregetar .

Tirane , me 15.06.2005

PER SHOQERINE " ALB-STAR " SH.P.K
ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Sadik ISMAILAJ

Idajet ISMAILAJ

Qendra Imp Eks ALB STAR Fier Albania

Alb-Star sh.p.k. Fier
Kthesa e Patosit , Fier
Tel & Fax 038540062
Cel. 0682021997;0682032785
E-mail:albstar@albmail.com

Nr 14/9 prot

Date 17 Shtator 2007

AUTORIZIM

Une i nenshkruari Sadik Ismailaj ne cilesine e Administratorit te Shoqerise"Alb-Star"sh.p.k Fier autorizoj Z. Elidg Sheho' qe te perfaqesoje Shoqerine "Alb-Star" sh.p.k. Fier per te kryer veprimet e nevojshme n e Qendren Kombetare te Rregjistrimit Tirane per nxjerrjen e Niptit Sekondar te filialit Lezhe.

Per ALB-STAR sh.p.k. Fier
Presidenti

Sadik Ismailaj

Ndërtim Imp Exp
ALB STAR
Fier Albania

Alb-Star sh.p.k. Fier
Kthesa e Patosit , Fier
Tel & Fax 038540062
Cel. 0682021997;0682032785
E-mail:albstar@albmail.com

Nr 7/9 prot

Date 17 Shtator 2007

AUTORIZIM

Une i nenshkruari Sadik Ismailaj ne cilesinę e Administratorit te Shoqerise"Alb-Star"sh.p.k Fier autorizoj Z. Aldo Shehaj qe te perfaqesoje Shoqerine "Alb-Star" sh.p.k. Fier per te kryer veprimet e nevojshme n e Qendren Kombetare te Rregjistrimit Tirane per nxjerrjen e Niptit Sekondar te filialit Sarande.

Per ALB-STAR sh.p.k. Fier
Presidenti

Sadik Ismailaj

Ndërtim Imp Exp
ALB STAR
Fier Albania

Alb-Star
CONSTRUCTION, IMPORT EXPORT
Alb-Star l.t.d. Zona Industriale Patos
Kthesa e Patosit
Fier, Albania.
Tel/Fax: +355 385 40062
Email: info@albstar.com

Nr.Prot. 13/9

Date 13/9/2007

Vendim Nr.4

I ortakeve te shoqerise Alb-Star shpk Fier.

Ne ortaket e shoqerise Alb-Star shpk Fier , me numer Nipti J62903512W te mbledhur sot ne date 13/09/07 vendosem ne vendimin tone nr.4 si me poshte:

1- Te nxirren Niptet Sekondare ne filialet Sarande dhe Lezhe.
2- Ngarkohet drejtoria ekonomike e shoqerise te marre masa per pajisjen me Nipt Sekondar te ketyre filialeve.

Ortaket e shoqerise Alb-Star shpk, Fier

Idajet Ismailaj

Sadik Ismailaj

Ndërtim Imp Exp ALB STAR Fier Albania

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE

NUMRI SERIAL:
3251660006

ÇERTIFIKATE REGJISTRIMI

Personit të Tatueshëm:

ALB-STAR SH.P.K.

Me adresë kryesore:

Rr : KTHESA E PATOSIT Nr
PATOS FIER

I jepet ky numër identifikimi (NIPT):

J62903512W

DATA E LËSHIMIT:
15/06/2005

DEGA E TATIMEVE

(Emri Mbiemri)

Certifikatë mbetet pronë e Ministrisë së Financave dhe duhet të kthehet në rast se ka ndryshim të ndonjë detaji ose ndërpritet detyrimi ligjor për të qenë person i tatueshëm.